



Data: 11.08.2026

KËRKESË

Kërkues: Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, me NIPT K42407012T, me adresë Rruga "Llazi Miho" Nd. 6, Sh. 1, Kat 1, Kombinat, Tiranë.

Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC): Tel: 068 4030111

Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban, me adresë "Kthesa e Kamzës, Pallatet Malezjane"

Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC): Shoqataetransportit@gmail.com

LËNDA: Kërkesë urgjente për disbursimin e kompensimit të miratuar për karburantin dhe vijimin e skemës së kompensimit për operatorët e transportit publik.

DREJTUAR: KRYEMINISTRISË

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Z.Ervin DEMO

BASHKISË TIRANË

Kryetar

Zj.Anuela RISTANI

Drejtore i Përgjithshëm i Punëve Publike

Z.Enton PUNAVIJA

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z.Enea KARAKACI

MINSITRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Z.Petrit MALAJ



MINSITRISE SË EKONOMISE DHE INOVACIONIT

Zj, Delina IBRAHIMAJ

Të nderuar,

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas dhe Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban, në përfaqësim të operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e transportit publik qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, ju drejtohen në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare me të cilën po përballen aktualisht shoqëritë e transportit publik, si dhe me zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 13.05.2026, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, në kushtet e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve". Nëpërmjet këtij vendimi është parashikuar kompensimi i operatorëve të transportit publik në masën 50 (pesëdhjetë) lekë për litër karburant, për sasinë e karburantit të konsumuar gjatë muajve mars, prill dhe maj 2026. Operatorët e përfaqësuar nga të dyja shoqatat kanë vepruar në përputhje me procedurat dhe kërkesat e përcaktuara në vendimin e sipërcituar, duke paraqitur dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara pranë institucioneve përgjegjëse brenda procedurave të përcaktuara. Nga ana e operatorëve janë përmbushur detyrimet që lidhen me dokumentimin e aktivitetit të transportit, sasive të karburantit të konsumuar dhe elementeve të tjera të kërkuara për përfitimin e kompensimit.

Pavarësisht përmbushjes së këtyre procedurave dhe faktit që masa e kompensimit është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, operatorët vijnë të mos kenë përfituar financiarisht kompensimin për të tre muajt mars, prill dhe maj 2026. Kjo situatë po krijon vështirësi të konsiderueshme në administrimin financiar të operatorëve, të cilët, në pritje të zbatimit të vendimit dhe disbursimit të kompensimit, kanë vijuar të përballojnë me burimet e tyre financiare kostot e aktivitetit, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit të transportit publik për qytetarët.

Ndërkohë, problematika që ka justifikuar ndërhyrjen e Qeverisë dhe miratimin e VKM-së nr. 341, datë 13.05.2026, nuk rezulton të jetë tejkaluar. Çmimi i karburantit vijon të qëndrojë në nivele të krahasueshme me ato të muajve për të cilët u miratua kompensimi, duke ruajtur të njëjtën barrë financiare mbi operatorët e transportit. Karburanti përbën një prej komponentëve kryesorë dhe të pazëvendësueshëm të kostos së transportit publik. Për shkak të konsumit të lartë ditor të flotave, çdo diferencë e konsiderueshme në çmimin për litër reflektohet drejtpërdrejt në kostot mujore të operatorëve dhe në aftësinë e tyre për të garantuar numrin e mjeteve, frekuencën e linjave dhe standardin e shërbimit të ofruar.



Në këto kushte, situata bëhet edhe më problematike për shkak të dy faktorëve që tashmë veprojnë njëkohësisht:

- a. nga njëra anë, kompensimi i miratuar për muajt mars, prill dhe maj 2026 nuk është disbursuar ende;
- b. nga ana tjetër, çmimet e karburantit vazhdojnë të mbeten në nivele të larta edhe pas periudhës së mbuluar nga VKM-ja.

Për rrjedhojë, operatorët janë duke u përballur me një mungesë të vazhdueshme likuiditeti dhe me rritje të kostove operative, duke cenuar drejtpërdrejt mundësinë për të mbajtur në qarkullim të gjithë flotën e mjeteve të nevojshme për realizimin normal të shërbimit publik. Kështu, Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas dhe Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban kërkojnë nga të gjitha institucionet përgjegjëse:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për përfundimin e procedurave dhe disbursimin e plotë të kompensimit që u takon operatorëve për muajt mars, prill dhe maj 2026, në zbatim të VKM-së nr. 341, datë 13.05.2026;
2. Informimin zyrtar të operatorëve dhe shoqatave mbi fazën në të cilën ndodhet procesi i kompensimit, problematikat që mund të kenë shkaktuar vonesën dhe afatin konkret të parashikuar për realizimin e pagesave;
3. Vlerësimin dhe miratimin e vijimit të skemës së kompensimit edhe për periudhën pas muajit maj 2026, për sa kohë që çmimet e karburantit dhe kushtet ekonomike që sollën miratimin e masës mbështetëse vazhdojnë të jenë të pranishme;
4. Zhvillimin e një komunikimi të menjëhershëm ndërinstitucional dhe me përfaqësuesit e dy shoqatave, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme që garanton vazhdimësinë normale të shërbimit të transportit publik.

Theksojmë se transporti publik është një shërbim me interes të drejtpërdrejtë publik dhe se operatorët kanë treguar përgjegjshmëri duke vijuar ofrimin e shërbimit pavarësisht kostove të shtuara dhe mungesës së disbursimit të kompensimit të miratuar. Megjithatë, kapaciteti financiar i operatorëve për të përballuar për një periudhë të pacaktuar këtë situatë është i kufizuar. Në rast se nuk do të ketë një reagim konkret dhe në kohë nga institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e situatës, operatorët e përfaqësuar nga të dyja shoqatat do të detyrohen të rishikojnë kapacitetet operative dhe numrin e mjeteve të transportit publik që mund të nxjerrin në qarkullim, në përputhje me mundësitë reale financiare dhe operative të secilit operator. Një masë e tillë nuk përbën zgjidhjen e dëshiruar të operatorëve dhe as të shoqatave, pasi do të ndikonte drejtpërdrejt në frekuencën dhe kapacitetin e shërbimit të transportit publik.



Megjithatë, në mungesë të mbështetjes financiare të miratuar dhe përballë vijimit të kostove të larta të karburantit, operatorët nuk mund të ngarkohen në mënyrë të pakufizuar me financimin nga burimet e tyre të një difference kostoje që cenon qëndrueshmërinë ekonomike të aktivitetit.

Për këtë arsye, kërkojmë ndërhyrjen tuaj urgjente, si për realizimin e kompensimit tashmë të miratuar për muajt mars, prill dhe maj 2026, ashtu edhe për marrjen e një vendimi mbi vijimin e mbështetjes financiare për periudhën pasuese, për sa kohë që vazhdojnë të ekzistojnë kushtet ekonomike dhe çmimet e karburantit që kanë shërbyer si bazë për miratimin e VKM-së nr. 341, datë 13.05.2026.

Duke vlerësuar rëndësinë sociale dhe ekonomike të transportit publik dhe ndikimin që çdo reduktim i kapaciteteve do të kishte mbi qytetarët, presim trajtimin me prioritet të kësaj kërkesë dhe një përgjigje konkrete nga institucionet përgjegjëse.

Me respekt,

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas

Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban

KRYETAR

KRYETAR

Kostandin Fon

Dalmar Greng

